

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 16

(KORRIK-DHJETOR 2024)

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr. ___ datë 23.11.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	4
2. Vendim nr. ___ datë 04.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit	5
3. Vendim nr. ___, datë 22.07.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	7
4. Vendim nr. ___, datë 01.02.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	9
5. Vendim nr. ___, datë 07.03.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	12
6. Vendim nr. ___ datë 07.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	14
7. Vendim nr. ___, datë 31.10.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	20
8. Vendim nr. ___, datë 16.04.2024, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	23
9. Vendim nr. ___, datë 07.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	26
10. Vendim nr. ___, datë 06.12.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.....	29
11. Vendim nr. ___, datë 28.10.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	32
12. Vendim nr. ___, datë 28.10.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit.....	33

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

1. Vendim Nr. ___ datë 23.11.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: “T+IE”

Të paditur:DTM / DAT

Objekti:1- Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit nr. ___ prot., datë _____
2-Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit nr. ___ datë _____
3-Shfuqizimin e Vendimit të DAT-së nr. ___ datë _____

Shuma e detyrimit tatimor: _____

Baza Ligjore : 1-Neni 472 i KPC /Neni 432 i KPP/ Neni 58, neni 63 i Ligjit 49/2012 “ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

2-Ligji nr.7928 datë 27/04/1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 33 pika 4 dhe Udhëzimi nr. 17 datë 13.05.2008.

3-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Nga kontrolli i shitjeve të shoqërisë për vitin 2015 ka rezultuar se shoqëria në rastet e shitjes derë më derë (shitje me kasë), kishte kryer shitje me çmim nën atë të publikuar nga furnizuesi kryesor, pra nuk kishte respektuar kërkesat e Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për TVSH-në në RSH”, neni 19, paragrafi 4.2. Nga kontrolli është bërë krahasimi i çmimit të shitjes së kryer nga shoqëria me çmimin e shitjes së publikuar nga furnizuesi kryesor “___” sh.a., nga ku rezultoi diferencë në vlerën _____ lekë. Diferenca e vlerës së shitjeve sipas çmimeve të publikuara nga furnizuesi kryesor me çmimet e shitura nga shoqëria prej _____ lekë, e korrektuar me 62.86%, të cilat janë shitjet derë më derë (shitje me kasë), na jep vlerën e shitjeve për t’u rivlerësuar prej _____ lekë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Referuar të dhënave dhe procedurës të vlerësimit të kryer, Gjykata çmon se ky vlerësim është mbështetur në metodën alternative të vlerësimit, konkretisht nenit 71, pika 1, gërma (b), ku citojmë “*Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur:deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara*”.

DTM bën vlerësim sipas metodave alternative nga administrata tatimore, duke qënë se gjatë kontrollit, inspektori ka konstatuar se deklarata e tatimpaguesit përmban të dhëna të pasakta.

Për të kryer këtë vlerësim, referuar Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, paragrafi 71.2 është i domosdoshëm vendimi i drejtorit të DRT të Tatimpaguesve të Mëdhenj. Në këtë paragraf është përcaktuar se “*Aplikimi i metodave alternative të vlerësimit tatimor sipas gërmeve b), c) dhe dh) të nenit 71 të Ligjit bëhet pasi është marrë një vendim me shkrim nga drejtori*

i drejtorisë rajonale". Pra, atributin për të vendosur për zbatimin e metodave alternative për vlerësimin tatimor e gëzon ekskluzivisht vetëm drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore. Vlerësimi tatimor është bërë duke zbatuar procedurat e mësipërme dhe pas marrjes së vendimit nr. ----prot., datë ---- të drejtorit të DRT të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me nr. ___ datë 07.02.2017: Rrëzimin e kërkesëpadisë së shoqërisë "T+IE".

2. Vendim nr. ___ datë 04.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria "A.F" sh.p.k.

Të Paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj/ Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti: Anulimin e vendimit nr. ___prot., datë ___ e DTM.

Anulimin e vendimit nr. ___prot., datë ___ të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Anulimin e vendimit nr. ___prot., datë ___ të Komisionit të Apelit vetëm përse i përket lënies në fuqi të detyrimeve.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore :

1-Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" neni 21 Udhëzimin nr. 5 datë 30.01.2006,

2- Ligji nr.7928 datë 27/04/1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

3-Ligji Nr.8560, datë 22.12.1999 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

1-Nga ana e inspektorit të palës së paditur Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj është ushtruar kontroll pranë palës paditëse shoqërisë "___" për periudhën tatimore që i korrespondon vitit ushtrimor Qershor 2005-Tetor 2006, në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga, TVSH-ja, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe për vitin 2005 është bërë kontroll edhe për tatimin mbi fitimin. Për këtë arsye, në përfundim të kontrollit të ushtruar, është përpiluar edhe raport kontrolli i datës ___, në të cilin inspektori tatimor ka pasqyruar rezultatet e konstatimeve të nxjerra nga të dhënat financiare të vëna në dispozicion nga shoqëria paditëse në këtë gjykim.

2. Në këtë raport kontrolli, inspektori tatimor ka parashtruar se: *Për artikullin banane, shoqëria "___ sh.p.k e ka tregtuar te klientet me pakicë, me një çmim që rezulton të jetë 10% më i lartë se ai i deklaruar nga kjo shoqëri në faturat e saj të shitjes, për subjektet e pajisur me NIPT. Inspektori i kontrollit ka konstatuar se shitjet janë kryer me kuti.*

Nga raporti i kontrollit ka rezultuar se: "...çmimi mesatar i blerjes pa për kuti është ___ lekë dhe

çmimi mesatar i shitjes pa TVSH për kuti është ___ lekë. Diferenca që rezulton midis çmimit/kuti është ___ lekë/kuti. Një kuti ka afërsisht 18 kg banane ose mesatarisht 90 copë. Sipas llogaritjeve rezulton që rritja absolute e çmimit të shitjes është ___/copë...”.

3. Për sa më sipër, bazuar në Urdhërin nr. ___, datë ___ DTM-së, në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për Procedurat Tatimore”, është urdhëruar rivlerësimi i çmimit të shitjes për artikullin banane për shitje të bëra në periudhën Qershor 2005-Tetor 2006 në masën 10% mbi çmimin mesatar të shitjes, pasi shoqëria ka bërë shitje me pakicë apo shitje për tregtarë ambulantë të paidentifikuar me të dhënat identifikuese tatimore në tregun e lirë dhe i ka deklaruar këto shitje me çmimin e shumicës.

4. Bazuar në urdhërin e mësipërm, nga ana e palës së paditur është kryer rivlerësimi i çmimit të shitjes së produktit banane me 10% për ta përafuar me çmimet e tregut dhe përfundimisht, ka konkluduar se: “...shoqërisë “___” i linden këto detyrime: **Totali i detyrimit ___ lekë**”.

Shoqëria i është drejtuar Gjykatës se rrethit Gjyqësor ku ka vendosur:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ___, datë ___ ka vendosur:

-Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë së ngritur nga paditësi “___” sh.p.k.

-Anullimin e pjesshëm të akteve administrative, Njoftim Vlerësimi Tatimor nr. ___, datë ___ i Degës së Tatimpaguesve të Mëdhenj, vendimit nr. ___ prot., datë ___ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe vendimit nr. ___ Prot, datë ___ të Komisionit të Apelimit për pjesën e detyrimeve tatimore që tejkalon shumën prej ___ (___) dhe lënien në fuqi për pjesët e tjera.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ___, datë ___ ka vendosur:

-Lënien në fuqi të vendimit nr. ___, datë ___ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ___, datë ___ të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit ___, datë ___ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj, duke parashtruar “...në shqyrtim të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, objektit dhe shkakut ligjor të kërtimeve të paditësit, të shprehura si në kërkesë padi ashtu dhe në pretendimet e tij gjatë gjykimit, vlerëson se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi është me natyrë administrative. Në këtë gjykim, pala paditëse ka kundërshtuar aktet administrative që kanë nxjerrë organet tatimore, brenda fushës së veprimtarisë së saj, bazuar në dispozitat e ligjit specifik mbi të cilat këto organe ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore. Për këtë arsye, kjo mosmarrëveshje përbën veprimtari administrative, e cila rregullohet në mënyrë të posaçme nga Ligji nr. ___, datë ___ “Për Procedurat Tatimore në RSh”, si dhe nga parashikimet e K.Pr.Administrative..”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ___ i Vendimit ___ datë ___ ka vendosur: “Prishjen e vendimit me nr. ___, datë ___ të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr ___ datë 04.11.2024, vendosi pranimin e padisë të shoqërisë “A.F”shpk.

Shoqëria për çdo shitje të kryer disponon faturat tatimore të shitjes për të cilat në 94.39% të vlerës totale të tyre për vitin 2005 dhe 99.17 të vlerës totale të tre për vitin 2006, janë plotësuar konform ligjit për TVSH-në, neni 36 “Faturat” pika 2 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij.

pika 8.1 “Të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore”, pasi këto fatura janë plotësuar më përshkrimin “Tregu i lirë” dhe bashkëlidhur kanë dhe kuponin tatimor të arkës regjistruese. DTM ka vepruar ne kundërshtim me ligjin nr.8560 dt.22.12.1999 ‘Per procedurat Tatimore në RSH’ si dhe ligjin nr.7928 dt.27.04.1995 ‘Për Tvsh’

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: Pranimin e padisë...

3. Vendim nr.____, datë 22.07.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “N” sh.p.k

Të Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë
Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Person i tretë: Avokatura e Shtetit, Dega Vlorë

Objekti: Anullim i akteve administrative, procesverbaleve të gjobave nr. ____ dhe nr. ____, datë ____, të Sektorit të Zbatimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore “Gjobë” nr. ____ prot, datë ____, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe i vendimit nr. ____ prot, datë ____ të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar përaktësisht Neni 54 pika 3, 55 pika 1, 122, pika 1, gërma b)i)i), 125;
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 54.3, 80.3c),108.5;
3. VKM-së Nr.781, datë 14.11.2007 (i ndryshuar), kreu I, pika 1;
4. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
5. Kodi i Procedurave Administrative.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria “N” sh.p.k me Nipt ____, me aktivitet Hotel- Bar- Restorant, i është nënshtruar një kontrolli nga inspektorët e sektorit të Zbatimit të Verifikimit në Terren pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Qendror Tiranë. Nga pikpamja ligjore kontrolli proceduralisht është i mbështetur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar. Pra, nga ana procedurale Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë legjitimohet plotësisht në kontrollin e ushtruar në subjektin

“ _____ ”.

Akt Konstatimi i mbajtur nga Inspektorët e sektorit të Zbatimit të Verifikimit në Terren pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Qëndror Tiranë është përcjell për procedura të mëtejshme në DRT Vlorë me shkresën nr. ____ Prot, datë ____ protokolluar me tonën me nr. ____ prot, datë ____ Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërin “ _____ ” është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial ____ datë ____ ku rezultoi se:

“...nga kontrolli i ushtruar në këtë subjekt në orën 17:35 rezultoi se: subjekti është i regjistruar në QKR ...Në momentin e kontrollit u konstatua një rast pa kupon tatimor tek bari dhe një rast tek restoranti, për këtë u veprua sipas ligjit...”

Në bazë të konstatimit të mbajtur janë mbajtur:

Së pari: Proces-Verbal Gjobë me nr. serial ____, datë ____, ku në bazë të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 122, pika 1 gërma (b,i), subjekti është penalizuar me gjobë në masën ____ lekë për mos lëshim kuponi tatimor në ambjentin e Barit për një tavolinë me klientë në orën 17:35.

Së dyti: Proces-Verbal Gjobë me nr. serial ____, datë ____, ku në bazë të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 122, pika 1 gërma (b,i), subjekti është penalizuar me gjobë në masën ____ lekë për mos lëshim kuponi tatimor në ambjentin e Restorantit për një tavolinë me klientë në orën 17:35.

Nisur nga fakti se nëpërmjet Proces Verbal Gjobës nr. ____ dhe ____ datë 08.08.2012, përcjell pranë DRT Vlorë me shkresën nr. ____ prot, datë 16.08.2012 të Sektorit të Zbatimit Taks- Forca në DPT, subjekti ____ Nipt ____ është penalizuar me gjobë ____ Lekë për dy raste moslëshim kuponi tatimor. Ju është bërë me dije se, duke qenë që subjekti është penalizuar me gjobë ____ lekë për dy raste moslëshim kuponi tatimor nëpërmjet akt konstatimit nr. ____ datë 04.09.2011 dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) Neni 122, pika 1 gërma b (ii) subjekti për herë të dytë duhet të penalizohet me gjobë ____ lekë për cdo shkelje. Në këto kushte DRT Vlorë ka kërkuar nga DPT Tiranë të lejohej për kontabilizimin e gjobës në vlerën ____ lekë=____ lekë.

Është bërë kontabilizimi nga ana e inspektorese së DRT Vlorë konform ligjit për procedurat tatimore. Subjekti është penalizuar me gjobë në vlerën ____ lekë, për këto penalitete subjekti është njoftuar me anë të aktit administrativ njoftim vlerësimi nr. ____ Prot, datë ____.

Nga sa mësipër mund të themi se, moslëshimi i kuponit tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave dhe shërbimeve, përbën shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobë në zbatim të nenit 122 të Ligjit nr.9920 datë.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), sipas të cilit citojmë: neni 122, pika 1.b.ii.

Me vendimin nr. ____, datë____ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesë padisë si të pa bazuar në fakte, prova e në ligj. Në lidhje me zbatimin e ligjit në kohë, gjykata arsyeton se akti administrativ është nxjerrë në vitin 2012, për vlerësimin nëse këto akte janë të vlefshme apo jo nga pikëpamja juridike, gjykata i është referuar ligjit të kohës kur janë nxjerrë këto akte dhe përkatësisht KPrA të vjetër. Në lidhje me çështjen, kriteri i kompetencës rezultoi plotësuar, zbatimi i procedurës është realizuar, procesverbali është nënshkruar pa vrejje nga administratori i shoqërisë dhe kriteri i ligjshmërisë është zbatuar plotësisht.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë reflekton zbatimin e kufijve të shqyrtimit gjyqësor. Ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet lidhur me këtë mosmarrëveshje,

duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për tu zbatuar prej saj në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe duke i interpretuar ato në mënyrë korrekte.

Ky vendim konstatohet se është rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit, konstatuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Ankimi i palës paditëse nuk përmban shkaqe për ndryshimin në favor të saj, të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. _____, datë 17.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kundër vendimit, nuk lejohet të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Vendim nr. _____, datë 01.02.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: A.B

Të paditur: Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Elbasan, me adresë lagjia “28 Nëntori”, Elbasan

Objekti : Kundërshtimin e aktit administrativ “Njoftim Vlerësimin” për detyrimet tatimore nr. _____ dhe _____ datë _____

Baza ligjore: Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 122, neni 55; Ligji Nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Ndaj tatimpagueses _____ me nipt _____ është ushtruar kontroll nga ana e inspektorëve të Hetimit Tatimor, sektori i Taks-Forcës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, më datës _____ në të cilën është konstatuar kasa fiskale me numër regjistri elektronik AE1000670, e cila nuk është në gjëndje pune dhe më datë _____ është ushtruar sërish kontroll nga ana e inspektorëve të Hetimit Tatimor sektori i Taks-Forcës ku është konstatuar se subjekti nuk e ka të instaluar kasën fiskale. Si rrjedhojë e akt-konstatimeve të mbajtura janë nxjerrë Njoftim Vlerësimi Nr. _____ prot datë _____ i cili përcakton gjobë për mospajse me kasë fiskale në vlerën _____ lekë, sipas akt konstatimit Nr. _____ datë _____ dhe Njoftim Vlerësimi nr. _____ prot datë _____ i cili përcakton gjobë për mospajse me kasë fiskale në vlerën _____ lekë, sipas Proces verbal Gjobë nr. _____ datë _____.

Tatimpaguesja ka akimuar pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor aktet administrative, ku me vendimin nr. _____ prot., datë _____ është vendosur refuzimi i ankimit për shkak se nuk është plotësuar ankimi me informacionin e plotë brenda afatit kohor ligjor edhe pse nga ana e DAT-së është kërkuar që të plotësohet ankimi me aktet administrative objekt apelimi, kjo gjë nuk është plotësuar nga ana e tatimpagueses e cila ka sjelle si rrjedhojë edhe refuzimin e ankimit. Aktet e mësipërme janë bërë objekt kontestimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Paditësja ka pretenduar në parashtrimet e saj gjatë hetimit gjyqësor në shkallë të parë se në periudhën që janë bërë konstatimet nga ana e inspektorëve të hetimit tatimor, lokali nuk ka qenë në shërbim pasi ka qenë në riparim e sipër dhe për këtë ka lidhur një kontratë sipërmarrje me datë 12.02.2012 me pale

kontraktuese sipërmarrës Shoqërinë ____ sh.p.k dhe investitor ____, me objekt rikonstruksioni i objektit lokal, pije freskuese pranë pikës së karburantit ____, Librazhd, sipas saj sipërmarrësi përfundon punimet më datë ____ . Konfirmon se kasa e regjistrimit është gjendur në ambientet e aktivitetit por nuk ka zhvilluar aktivitet, pasi nuk kishte filluar punë në kohën e kontrollit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin nr.____ datë ____ ka vendosur: Pranimin e kërkesë padisë të ngritur nga paditësja ____ duke shfuqizuar aktin administrativ “Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore” nr.____ prot., datë ____ dhe “Njoftim Vlerësimin” për detyrimet tatimore” nr.____ prot., datë ____.

Kundër Vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka paraqitur ankim Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan duke kërkuar ndryshimin e Vendimit nr.____ datë ____ si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin ligjor se Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan ka vepruar në përmbushje të kriterëve ligjore të përcaktuar në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi Nr.24, i Ministrit të Financave datë 02.09.2008, “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Njoftim Vlerësimin me Nr.____ datë ____ për detyrimin tatimor gjobë ____ lekë është akt administrativ i nxjerrë si rredhë e akt-konstatimit nr.____ datë ____ për mospajisje tatimpaguesit me kasë fiskale dhe Njoftim Vlerësimin me nr.____ datë ____ për detyrimin tatimor gjobë ____ lekë është akt administrativ i nxjerrë si rredhë e akt-konstatimit nr.____ datë ____ për mospajisje e tatimpaguesit me kasë fiskale. Penalizimi i tatimpagueses është bërë konform parashikimeve ligjore të nenit 122 pika 1 gërma “a” të Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në periudhën kur janë bërë konstatimet nga ana e inspektorëve të hetimit tatimor, pavarësisht se subjekti ka qenë në rikonstruksion, kjo nuk do të thotë që nuk duhet të përmbushë detyrimet e tij që rrjedhin nga ligji, neni 55 i Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e paisjes me kasë fiskale dhe lëshim të kuponit tatimor për çdo subjekt; *Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor*

Për rastin në fjalë në kushtet kur nuk është marrë në shqyrtim ankimi administrativ pasi kërkesa për apelim nuk është e plotë me kriteret e vendosura nga ligji, duke qenë se pala paditëse nuk ka ezuaruar rrugën administrative të ankimit, pasi Drejtoria e Apelit Tatimor ka refuzuar marrjen në shqyrtim të ankimit, referuar nenit 9, 16, 39/2 të Ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës duke të kishte vendosur, mospranimi e padisë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.____ datë ____ vendosi:

Ndryshimin e vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e padisë. Në vlerësimin e saj Gjykata Administrative e Apelit është ndalur fillimisht në identifikimin e saktë të objektit të mosmarrëveshjes, objekti i gjykimit të kësaj çështje janë pretendimet në themel të padisë së palës paditëse për paligjshmëri të sjelljes administrative të palës së paditur në momentin që ka ndërshkuar palën paditëse me gjobë në masën ____ lekë + ____ lekë, pala kundërshton për paligjshmëri Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore Tatimore nr.____ prot.,datë ____ dhe Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ prot., datë ____, ky është dhe objekti i

padisë dhe objekti i gjykimit në gjykimin në shkallë të parë. Në kushtet kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur pranimin e padisë së palës paditëse, objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit është ankimi i paraqitur nga pala e paditur kundër vendimit përfundimtar. Gjykata ka vlerësuar së kundërshtimi i paligjshmërisë së Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Tatimore nr.____ prot., datë ____ dhe Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr.____ prot., datë ____ është objekti i padisë, objekti i mosmarrëveshjes, objekti i ankimit dhe objekti i gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se sjellja administrative e palës së paditur është sjellje administrative në referim të nenit 2/1 dhe 2 të Ligji Nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenit 3/1/a të Kodit të Procedurave Administrative, dhe kundër tyre mund të ngrihet padi për shfuqizimin e saj si sjellje administrative e paligjshme.

Gjykata ndalet duke bërë dallimin e ligjshmërisë dhe pavlefshmërisë së aktit administrativ, referuar nenit 115,118,119 të Kodit të Procedurave Administrative, duke verifikuar fakte objekt verifikimi të çështjes dhe kuadrin ligjorë të zbatueshëm në zgjidhjen e drejtë të kësaj mosmarrëveshje.

Gjykata çmon se referuar nenit 35 të ligji Nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Barra e provës për të provuar se akti administrativ objekt kontestimi në gjykatë është i ligjshëm dhe për rredhojë nuk duhet të çenohet vlefshmëria e tij i takon organit publik të thirrur në cilësinë e palës së paditur në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar se pala e paditur ka paraqitur në gjykim të gjitha akte provuese të mbajtura/ mbledhura përgjatë hetimit administrativ, nga këto akte provohet se në vendin ku pala paditëse ushtronë aktivitetin tregtarë, ky aktivitet ka qenë i hapur ka pasur kasë fiskale e cila nuk ka qenë në punë. Nga ana e palës paditëse nuk është provuar sa pretendon, pasi fakti se ambienti ku ushtron aktivitetin mund të ketë qenë në rikonstruksion por, kjo nuk do të thotë që apriori se rikonstruksioni ka penguar ushtrimin e aktivitetit tregtar. Gjykata thekson se, faktet objekt verifikimi mund të jenë fakte formuese apo konstruktive, të cilat sjellin lindjen e një të drejte, fakte formuese gjatë procesit gjyqësor duhet të provohen nga pala që pretendon egzistencën e tyre, pala që pretendon lindjen e një të drejte (zakonisht paditësi). Gjykata konkludon në lidhje me pretendimin e paditësi për mos ushtrim të aktivitetit tregtare gjatë periudhës së inspektimit si të pambështetur në prova. Fakti që në ambiente e palës paditëse ushtrohej aktivite dhe paisja fiskale nuk ka qenë në punë është mëse i mjaftueshëm për të konsideruar këtë shkelje të legjislacionit tatimor të kryer nga paditësi. Fakti që ambienti ka qenë në rikonstruksion mbështete në një leje për kryerje punimesh datë 12.02.2012 të lëshuar nga vetë Z. ____ (në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Librazhd), përkundrejtë vetes së tij dhe bashkëshortes së tij _____. Një leje ndërtimi e lëshuar për vete e vet dhe pa asnjë numer identifikues nuk arrin të provoj faktin e pretenduar se në ambiente e aktivitetit të tij po kryhen punimet sipas këtij akti.

Vendimi i Gjykatës:

1. Ndryshimin e vendimit nr.____ datë 16.06.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e padisë
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarim të palës paditëse
3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

5. Vendim Nr._____, datë 07.03.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Paditës : Shoqëria “S” Sh.p.k, identifikuar me nipt _____, seli Katundi i Ri, Nj.A Bradashesh, përfaqësuar nga administratori i saj Z._____

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti i padisë: Anullimi i aktit administrativ Akt Konstatimi nr._____ datë _____ të DPT Tiranë duke konstatuar paligjshmërinë e tij. Anullimi i të gjithë akteve të tjera administrative të përpiluara bazuar në këtë akt administrativ.

Baza ligjore: Neni 31,32,106,153 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Ligji Nr.49/2012 “Për Gjykata Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, neni 15, 17, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzues nr.22225 datë 16.07.2015 i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Në zbatim të Urdhërit të Punës me nr. ____ prot., datë _____, inspektorët e zbatimit në Sektorin e Task-Forcës në drejtorinë e Hetimit Tatimor, kanë ushtruar kontroll në tatimpaguesin “ _____” sh.p.k., në raste kur organet tatimore konstatojnë shkelje administrative përveç akt-konstatimit mbahet edhe proces-verbali i gjobës sipas natyrës së çështjes. Për rastin në fjalë, inspektorët e zbatimit në Sektorin e Task-Forcës, kanë mbajtur në vend Akt-Konstatimin me nr. ____ datë ____ ku kanë evidentuar shkeljen administrative dhe Proces-Verbalin e Gjobës nr.____ datë _____ku është penalizuar subjekti me gjobë në vlerën ____ lekë për mosdeklarim të një punonjësi. Meqënëse subjekti “ _____” sh.p.k me nipt_____, e ka adresën në Elbasan, si rrjedhim është tatimpagues i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan që nga viti 2004 dhe të gjitha deklaratimet në sistemin informatik tatimor online dhe pagesat në Bankat e Nivelit të Dytë, i kryen në adresë dhe për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, ku ndodhet e administruar dosja e këtij subjekti dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruar përkatës.

Në këto kushte sipas procedurës për ndjekje të mëtejshme Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka përcjellë shkresërisht Akt-Konstatimin me nr. ____ datë _____, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan në mënyrë që nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit këtu të kryeshin verifikimet e mëtejshme në listëpagesat e deklaruara nga vetë subjekti. Pas verifikimeve të kryera nga kjo drejtori në Sistemin Informatik Tatimor C@TS_të drejtorisë sonë, ka rezultuar se personi i gjetur në momentin e ushtrimit të kontrollit, nga grupi i inspektorëve në Sektorin e Task-Forcës, Z._____ me datëlindje 09.06.1973, nuk rezulton i deklaruar si punonjës pranë subjektit “ _____” sh.p.k me nipt _____. Deklarimi i këtij punonjësi pranë organit tatimor nuk është kryer, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës nga ana e paditësit siç e parashikon neni 119 i Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Si rredhojë e akt-konstatimit të mbajtur në tatimpaguesin _____ sh.p.k është nxjerrë nga Drt-Elbasan “Njoftim Vlerësimi” për detyrimet Tatimore.

Pala paditëse ka pretenduar anulimin e aktit administrativ, Akt Konstatimi nr._____ datë _____, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat ligjore në fuqi, duke e konsideruar atë të paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm. Pala paditëse ka pretenduar se akti i konstatimit i mbajtur nga inspektorët është një akt i njëanshëm i cili nuk i është bërë i ditur ndërsa në lidhje me gjetjet e

konstuara ato janë të pavërteta duke pretenduar se nuk ekziston asnjë shtetas me emrin _____. Padiësi ka pretenduar se nga ana e organi tatimor nuk është respektuar procedura e kontrollit tatimor sipas referimeve ligjore të nenit 81 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, “Njoftimi i kontrollit tatimor”, si dhe inspektorët nuk kanë kryer procedurat ligjore sipas kërkimeve të ligjit dhe udhëzimeve të veçanta në rastin e konstatimit të një punonjësi të padeklaruar, për këtë arsye gjykata duhet të shpallë aktin administrativ, akt-konstatimin si të paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm.

Në kuptim të seksionit nr.3, nenit 108 dhe nenit 109 të Ligjit nr.44/2015 të “Kodit të Procedurave Administrative”, akte administrative të kundërshtuara janë nxjerrë në përputhje me ligjin dhe nuk jemi përpara rasteve të paligjshmërisë dhe pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Akti administrativ është nxjerrë nga një organ administrativ kompetent, në përfundim të një procedure administrative të kryer në përputhje me ligjin. Referuar nenit 70 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar *është kompetencë* e DRT-Elbasan e drejta për të nxjerrë njoftimin vlerësimin tatimor pasi pala padiëse është subjekt i regjistruar pranë DRT-Elbasan dhe është nën juridiksionin dhe kompetencën e kësaj drejtorie. Akti administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore me nr. __ prot., datë __, është një akt tërësisht i bazuar në procedurën që parashikon ligji nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Udhëzimi Nr.24, i Ministrit të Financave datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.

Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr. __ prot. datë __ është një akt administrativ i hartuar, në zbatim të Akt-Konstatimit me nr. __ datë __, akt që ka rezultuar nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e Sektorit të Task- Forcës në Drejtorinë e Hetimi Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, sipas udhërit të shërbimit nr. __ prot., datë __, në zbatim të Planit Operacional me nr. __ prot., datë __, nga ku është konstatuar një punonjës i padeklaruar për të cilin është penalizuar subjekti sipas parashikimeve të nenit 119 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për rastin në fjalë kontrolli ka të bëjë me verifikimin në adresën e tatimpaguesit në zbatim të ligji nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 80 “Kontrolli Tatimor”, si dhe Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, paragrafi 80.3 pika “c”, ku përcakton llojet e kontrolleve tatimore, konkretisht pika “c” “Verifikimin në vend” parashikon se: Verifikimet në vend janë verifikime të shkurtra që synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vendimin e saj nr. __, __ datë __ vendosi pranimin e padisë dhe shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi nr. __ prot. datë __, duke vlerësuar se padia e padiësit është e mbështetur në ligj. Gjykata ka vlerësuar se pavarësisht

pretendimeve të organit publik nuk u provua që paditësi “___” Sh.p.k të ketë konsumuar kundravajtjen administrative të “Mosdeklarimit të punonjësit” referuar nenit 119 të ligji nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Ndërkohë që, organi publik i paditur pretendon se paditësi nuk kishte deklaruar në momentin e kontrollit si të punësuar shtetasin ___, gjatë gjykimit u provua përmes shkresës nr. ___ prot., datë ___ të Zyrës së Gjëndjes Civile, Njësia Administrative nr.5, Bashkia Elbasan, se në regjistrim kombëtar të gjëndjes civile nuk ekziston asnjë shtetas me gjeneralitetet ___. Gjykata sjellë në vëmendje referuar nenit 35 të Ligjit Nr.49/2012 “Për Gjykata Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” se barra e provës për të provuar ligjshmërinë e një akti administrativ, kontratat administrative apo veprimi tjetër administrativ të nxjerrë pa kërkesë të palës i përket organit publik. Në kushte kur organi publik nuk arrin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë prej tij, ndodhur dhe para faktit ku nga pala paditëse gjatë gjykimit u provua se shtetasi i identifikuar nga organi publik si i padeklaruar në organin tatimor nuk ekziston, gjykata vlerëson se në tërësi procedura administrative nuk është në përputhje me ligjin dhe akte administrative të nxjerra nga organi publik duhet të shfuqizohen.

Vendimi i Gjykatës:

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimit për Detyrimin Tatimor nr. ___ prot., datë ___ Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan si dhe Vendimi nr. ___ prot., datë ___ të Drejtorisë së Apelit Tatimor.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura solidarisht.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.

6. Vendim nr. ___ datë 07.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: D.K, i regjistruar me Nipt ___, person fizik me vend të ushtrimit të aktivitetit lagje “18 Shtatori”, Gjirokastër, përfaqësuar nga administratori ___.

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore, Gjirokastër.

Drejtoria e Apelit Tatimor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë.

- Objekti:**
1. Shfuqizimin tërësisht të Vendimit ekzekutiv të posaçëm tatimor, njoftuar sipas shkresës nr. ___ Prot. datë ___, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Gjirokastër.
 2. Shfuqizimin tërësisht të Vendimit nr. ___ Prot. datë ___, të Drejtorisë së Apelit Tatimor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë.
 3. Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë të gjitha shpenzimet gjyqësore.

Baza Ligjore: Nenet 31 e vijues, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenet 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Ligji Nr.49/2012 “Për Organizimin dhe

Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzim i Ministrit të Financave, Nr.24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat” dhe Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Paditësi, është regjistruar si tatimpagues pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë nga data ____, me NUIS ____, Statusi ligjor “Person fizik”, me përfaqësues z. ____, dhe objekt aktiviteti “Fabrikimi i bukës dhe i ëmbelsirave të freskëta. Prodhimi i bukës, prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve”.

Në zbatim të Urdhër–Pune nr.____ prot., datë ____ dhe Urdhër–Pune nr.____ prot., datë ____, është ushtruar kontroll nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe në përfundim janë mbajtur Akt–Konstatimet nr.____ e nr.____ datë ____ dhe Akt–Konstatimi nr.____ datë _____. Nga konstatimi ka rezultuar se paditësi rezulton me një xhiro mesatare ditore në shumën ____ lekë e cila e konvertuar në ditë kalenderike të mbetura të vitit ushtrimor 2017 shkon në shumën ____ lekë (____ lekë x 160 ditë = ____ lekë).

Në lidhje me Akt–Konstatimet nr.____ e nr.____ datë ____, dhe Akt–Konstatimi nr.____ datë ____, në zbatim të nenit 68 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka të drejtën e kryerjes së vlerësimit tatimor kur vëren se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor.

Bazuar në vlerësimin e kryer sipas Akt–Konstatimeve nr.____ e nr.____ datë ____, dhe Akt–Konstatimi nr.____ datë ____, kontrolleve nga zyra të ushtruara nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor si dhe me verifikimin e xhirove të pajisjes fiskale për vitin 2017, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me shkresën MEMO nr.____ prot. datë datë ____, ka kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë tatimore për këtë subjekt duke shtuar Tatim mbi Fitimin.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në vijim të procedurës nxorri aktin e njoftimit nr.____ prot., datë ____, për ngarkimin me përgjegjësi tatimore Tatim mbi Fitimin prej datës ____, për t’ia komunikuar paditësit në adresën e vetëdeklaruar.

Duke mos qenë dakort me detyrimin që i ka lindur ndaj organit tatimor, paditësi është ankuar për njoftimin nr.____ prot., datë ____, pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ të ankimit, me vendimin nr.____ prot., datë ____, Drejtoria e Apelitit Tatimor Tiranë, ka vendosur :

Rrëzim të ankimit të tatimpaguesit ndaj ndryshimit të përgjegjësisë tatimore sipas shkresës nr.____ datë. 17.01.2017 nxjerrë nga DRT Gjirokastrë.

Për kundërshtimin e këtij vendimi paditësi, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi me palë dhe objektin e sipërcituar.

Vlerësimi i gjykatës:

Vendimi nr. ___, datë ___ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është marrë në përputhje me ligjin material dhe atë procedural, për arsyet e mëposhtme:

Siç ka rezultuar, pranë subjektit ___, person fizik, është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, duke mbajtur dhe akt konstatimet përkatëse: Akt Konstatimi nr. ___, datë ___, Akt Konstatimi nr. seria ___, datë ___, Akt Konstatimi nr. ___, datë ___, nëpërmjet të të cilëve është konstatuar se subjekti rezulton me një xhiro mesatare ditore në shumën ___ lekë.

Në vijim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë është përgatitur MEMO me nr. ___ prot., datë ___ me lëndë “Ndryshim përgjegjësie tatimore” për subjektin ___.

Pala paditëse ka marrë dijeni për shkresën kthim përgjigjen nr. ___ prot., datë ___ të DRT Gjirokastrë. Pasi është njohur me detyrimin që i ka lindur ndaj organit tatimor, ka ushtruar të drejtën e tij duke u ankuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor, Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ të ankimit Drejtoria e Apelit Tatimor ka disponuar Vendimin nr. ___ prot., datë ___, duke vendosur: *“Rrëzim të ankimit të tatimpaguesit ndaj ndryshimit të përgjegjësisë tatimore sipas shkresës nr. ___, datë ___ nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.”*

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, me kërkespadinë, objekt gjykimi.

Me vendimin nr. ___, datë ___, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Shfuqizimin e Vendimit administrativ nr. ___ prot., datë ___ i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe vendimit nr. ___ prot., datë ___ i Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përsa i përket bazueshmërisë në ligj të arsyetimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, vlerësuar brenda shkaqeve të ankimit të palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit i referohet Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013, “Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël”, ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Në nenin 16 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” parashikohet:

Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin

1. Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen këta persona:

- a) Personat juridike dhe ortakëritë të parashikuara në nënparagrafët “iii” dhe “iv” të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 2 me të ardhura mbi 8 000 000 lekë në vit.*
- b) Personat juridikë, ortakëritë apo bashkimet e tjera të personave të themeluara ose të organizuara në bazë të një ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

- c) *Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbifitimin mbi biznesin e vogël.*
- d) *çdo person joresident që nukparashikohet nga shkronjat "a", "b " ose "c", të kësaj pike, dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat.*
- 2. *Çdo person, sipas kuptimit të këtij ligji, pavarësisht nga statusi oseforma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekt i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë eregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekt, që i nën shtrohet tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.*

Në pikën 2 të nenit 43 ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” parashikohet: 2. Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore përkatëse, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll, i kryer nga administrata tatimore, qendrore ose vendore, administrata që kryen kontrollin njofton administratën tjetër, brenda 10 ditëve kalendarike pas këtij ndryshimi.

Në pikën 2.3.9 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi te ardhurat” parashikohet:

2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g). Në këtë grup përfshihet Gdo Iloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. IVë këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nukjanë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastetpersoni përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme te biznesit. Nukpërfshihet në pikën "g" të nenit 8 të ligjit asfitimi neto i personavefizikë tregtarë, pavarësisht nëse ky i fundit i nënshtrohet tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. Të ardhurat e personitfizik tregtar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar taten vetëm sipas kreut III "Tatimi mbifitimin” (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar, për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në Vit. Personifizik tregtar nuk ka personalitetjuridik të ndryshëm nga individ (i regjistruar si tregtar), ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare dhe ortakëve të saj individë dhe rrjedhimishtfitimi neto i personitfizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhurpersonale e individit, subjekt i pikës "g" të nenit 8 të ligjit.

Edhe në rastet kur paguesi i të ardhurës është person juridik apo fizik i regjistruar në organet tatimore shqiptare ose Gdo ent, organizatë joqeveritare, apo organ i qeverisjes qendrore apo vendore në Shqipëri, apo përfaqesi e organizmave ndërkombëtare apo ambasadë e huaj në Shqipëri, tatimi mbahet në burim në masën 15% të pagesës dhe derdhet në organin tatimor përkatës brenda

datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. IVë rastet kur përfituesi është individ rezident Shqiptar dhe paguesi është person jo-rezident (i pa regjistruar në organet tatimore Shqiptare), përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë tatimin në organin tatimor përkatës jo me vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Deklarimi i të ardhurës dhe i shumës së tatimit bëhet sipas modelit të formularit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

Në pikën 43.2.1 e vijues të udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” parashikohet:

43.2. I Në rastet kur përgjegjësia tatimore pas regjistrimit fillestar ndryshon, personi i tatueshëm është i detyruar të njoftojë drejtorinë tatimore rajonale të juridiksionit për ndryshimet e ndodhura. Deklarimi i ndryshimit të përgjegjësive tatimore për të gjithë kategorinë e tatimpaguesve që regjistrohen nga QKB-ja dhe nga AT, mund të bëhet edhe online nëpërmjet faqes së shërbimeve elektronike e-albania, pa qenë e nevojshme që tatimpaguesi të paraqitet në sportelet e shërbimit në DRT.

Formulari i plotësuar do të dërgohet në mënyrë elektronike në sistemin elektronik të tatimeve, të adresuar për DRT-në përkatëse e Cila do të bëjë aprovimin e ndryshimit të përgjegjësive.

Drejtoria rajonale tatimore përkatëse, pasi bën verifikimin e të dhënave të dorëzuara, brenda 2 ditëve pune aprovon ndryshimin e përgjegjësive dhe njofton tatimpaguesin menjëherë në Ilogarinë e tij elektronike në e-albania ose në një nga mënyrat e tjera ligjore të komunikimit me tatimpaguesin. Drejtoria rajonale tatimore i reflekton këto ndryshime në sistemin tatimor, duke bërë sistemimet e duhura në dosjen elektronike të personit të tatueshëm.

Për shembull, rast i ndryshimit të përgjegjësive tatimore mund të jetë tejkalimi i volumit të qarkullimit prej 8 milionë lekësh. Në këtë rast, përgjegjësia tatimore e personit të tatueshëm ndryshon, domethënë nga person i tatueshëm për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël duhet të kalojë në tatimpaguesi i tatimit mbi fitimin.

Rast tjetër i ndryshimit të përgjegjësive tatimore mund të jetë shtimi i përgjegjësive tatimore për tatimin në burim, shtimi i përgjegjësive për TVSH-në apo dhe ndryshimi i përgjegjësive për kontributet e sigurimeve shoqërore, p.sh., nga person i vetëpunësuar i vetëm, ai mund të kalojë në person i vetëpunësuar me punëmarrës etj. Edhe në këtë rast, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore për çdo ndryshim, e Cila reflekton këto ndryshime në sistemin e administrimit tatimor.

43.22 Personi i tatueshëm që plotëson kushtet e mësipërme, për të bërë ndryshimin e duhur, duhet të plotësojë brenda 15 ditëve nga momenti që përgjegjësia e tij tatimore ka ndryshuar, formularin e ndryshimeve në regjistrim dhe ta dërgojë atë në drejtorinë rajonale të tatimeve të juridiksionit, për të bërë ndryshimin e kërkuar, në dosjen e tatimpaguesit në sistemin tatimor.

43.23 Në rastet kur një person i tatueshëm nuk ka njoftuar administratën tatimore për ndryshimin e ndodhur, megjithëse ka detyrim ligjor për ta bërë një gjë të tillë, dhe një gjë e tillë konstatohet dhe verifikohet nëpërmjet një kontrolli nga administrata tatimore, kjo e fundit bën menjëherë ndryshimin e duhur dhe njofton personin e tatueshëm. Kështu, për shembull, në bazë të një kontrolli tatimor të kryer në vend të personit i tatueshëm apo në bazë të të dhënave të importeve të marra nga dogana rezulton se një tatimpaguesi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, ka plotësuar kushtet

për të qenë person i regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, por vetë personi i tatueshëm, megjithëse i detyruar sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, nuk ka bërë regjistrimin si tatimpagues TVSH-je. Në këtë rast, administrata tatimore gëzon të drejtën, për të plotësuar në emër të personit të tatueshëm, formularin përkatës të ndryshimeve në regjistrim, ta hedhë atë në sistemin elektronik dhe të njoftojë njëkohësisht për këtë personin e tatueshëm.

Ndërkohë që në pikën 1 të Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013, “Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël”, parashikohet se: “Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000, 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Për efekt të zbatimit të ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, me biznes do të kuptojmë çdo person fizik ose juridik, i cili ushtron veprimtari ekonomike për qëllime fitimi. Periudha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periudha nga 1 janari deri në 31 dhjetor. Në çdo rast, në qoftë se gjatë vitit kalendarik, qarkullimi tejkalon ose parashikohet të tejkalojë kufirin prej 8 milionë lekë, personi fizik ose juridik detyrohet të regjistrohet si tatimpagues i tatimit mbi qarkullimi që merret parasysh është qarkullimi gjithsej i realizuar nga i njëjti person, pavarësisht nga statusi i tij. Në qoftë se një person ka disa veprimtari në të njëjtin vend ose në vende të ndryshme, qarkullimi që merret për bazë përfshin qarkullimin e të gjitha veprimtarive, në të gjitha vendndodhjet ku zhvillohet ajo.”

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërm rezulton se, Drejtoria Rajonale Tatimore bën ndryshimin e përgjegjësisë tatimore të tatimpaguesit, kur tejkalohet volumi i qarkullimit prej 8 milionë lekësh. Periudha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periudha nga 1 janari deri në 31 dhjetor.

Në çështjen, objekt gjykimi, nuk rezulton që të jetë tejkalar volumi i qarkullimit prej 8 milionë lekësh për palën paditëse, për rrjedhojë nuk mund të ndryshohet përgjegjësia tatimore e tij. Konkretisht, nga përmbajtja e raportit tatimor të printuar nga pajisja fiskale e paditësit, për periudhën kohore 01.01.2017 deri në 24.07.2017 rezulton se, qarkullimi total së bashku me TVSH është në shumën ___ lekë. Pas zbritjes së vlerës së TVSH prej ___ lekë, rezulton një qarkullim total (pa TV SH) prej ___ lekë. Kjo shumë është qarkullimi i realizuar në pajisjen fiskale deri në ditën e kontrollit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

Ndërkohë që, llogaritja e xhiros vjetore e bërë nga pala e paditur me metodën e parashikimit/vlerësimit alternativ nuk është në përputhje me udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr.32, datë 31.12.2013, “Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël”, ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Përsa kohë ekziston një pasqyrë financiare, e memorizuar në pajisjen fiskale, pra një dokumentacion fiskal që hedh dritë në lidhje me xhirron dhe të ardhurat e arkëtuara nga paditësi, atëherë metoda e parashikimit/vlerësimit alternativ, e përdorur nga administrata tatimore nuk është në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjit. Për llogaritjet e bëra nga pala e paditur nuk kanë qenë objektive dhe reale. Kjo llogaritje është bazuar në vlerësimin e përafërt, referuar qarkullimit mesatar ditor të konstatuar nga administrata tatimore gjatë monitorimeve të kryera ku rezultoi se, qarkullimi

i tatimpaguesit është në shumën ___ lekë (___ ditë). Pra kjo llogaritje nuk i përgjigjet gjendjes së faktit, në raport me ligjin e aplikueshëm.

Në respektim të detyrimeve procedurale të përcaktuara në nenin 35 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, l. *Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.*

Në këndvështrim dhe mbështetje të këtij parashikimi ligjor, i takon organit publik detyrimi që të provojë para gjykatës ligjshmërinë e aktit administrativ, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Në rastin konkret, nga tërësia e provave shkresore, pjesë e dosjes gjyqësore, pala e paditur nuk ka paraqitur prova shkresore, me të cilat të provohet qartësisht fakti, se paditësi ka tejkalluar volumin e qarkullimit prej 8 milionë lekësh. Për rrjedhojë, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se, veprimtaria administrative e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë është një veprimtari e paligjshme, dhe me të drejtë është shfuqizuar nga gjykata administrative e shkallës së parë.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi nr. ___, datë ___ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, është marrë në përputhje me ligji, dhe si i tillë duhet lënë në fuqi. Në këto kushte ankimi i palës së paditur nuk ka shkaqe ligjore për pranimin e tij dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit çmon se, vendimi nr. ___, datë ___, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë duhet lënë në fuqi, bazuar në gërmën b) të nenit 50 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në të cilën parashikohet se: “Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: b) lenien nëfuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.”

Vendimi i gjykatës: Lënie në fuqi të vendimit nr. ___, datë 16.01.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

7. Vendim nr. ___, datë 31.10.2024, i Gjykatës Administrative së Apelit

Paditës: V.L, e bija e Enver dhe e Xhevrie, e datëlindjes ___, lindur dhe banuese në Gjirokastrë, Lagja “18 Shtatori”.

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore, Gjirokastrë.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë.

- Objekti:** 1. Shfuqizim tërësisht të aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor për detyrimet nr.____ prot. datë ____, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.
2. Shfuqizimin tërësisht të Vendimit me nr.____ prot., datë ____, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.
3. Detyrimin e palëve të paditura, të paguajnë shpenzimet gjyqësore.

Shuma e detyrimit tatimor: Gjoha nga verifikimi në terren në shumën totale ____ lekë.

Baza Ligjore: Nenet 31 e vijues, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Nenet 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Ligji nr.49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Ligj nr.7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, Ligj nr.7697 datë 07.04.1993 “Për Kundërvajtjet Administrative”, i ndryshuar, Ligj nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzim i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligj nr.9136 datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore”, i ndryshuar, V.K.M. nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” i ndryshuar, Udhëzim nr.23 datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Paditësi, është regjistruar si tatimpagues pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë nga data 09.09.2015, me NIPT ____, Statusi ligjor “PF, Person fizik” dhe objekti i aktivitetit “Bar-kafe”.

Bazuar në Urdhërin e Punës nr.____ prot., datë 11.06.2019, inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugor, kanë ushtruar kontroll në vendushtrimin e biznesit në datën 13.06.2019, duke mbajtur Akt–Konstatimi nr.____ datë 13.06.2019, ku është konstatuar se nuk janë përditësuar të dhënat, nuk mban dhe mirëmban në gjendje pune pajisjen fiskale si dhe mban punonjës të padeklaruar në organin tatimor.

Në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XIV “Sanksionet”, për shkeljet e konstatuara, është mbajtur Proçes–verbal Gjobje nr.____, nr.____, nr.____ datë 13.06.2019, për penalizimin e paditësit në shumën ____ lekë në total.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, pasi u njoh me aktet e mbajtura nga inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugor, në vijim të procedurës nxorri aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.____ prot., datë ____, për t’ia komunikuar paditësit në adresën e vetëdeklaruar.

Duke mos qenë dakort me detyrimin që i ka lindur ndaj organit tatimor, paditësi është ankuar për aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.____ prot., datë ____, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ të ankimit, me vendimin nr.____ prot., datë ____, Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, ka vendosur :

Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi, Njoftim Vlerësimi për detyrimet Nr. ___ prot, datë 06.01.2020 (___), nxjerrë nga DRT Gjirokastrë, gjoha në shumën totale ___ lekë.

Për kundërshtimin e këtij vendimi paditësi, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi me palë dhe objektin e sipërcituar.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit si mori në shqyrtim çështjen në dhomë këshillimi në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, çmon se është në kushtet e pamundësisë procedurale për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit nr. ___, datë 14.09.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë për shkak se vlerëson se, ankimi i palës paditëse kundër këtij vendimi është paraqitur tej afatit kohor ligjor.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, sipas nenit 127 të K.Pr.Civile vendimi i mospranimit të padisë është një vendim jopërfundimtar i cili i jep fund procesit gjyqësor pa e zgjidhur çështjen në themel, ashtu sikurse edhe vendimi për pushimin e gjykimit të çështjes.

Në ligjin nr.49/2012 të ndryshuar dhe në K.Pr.Civile nuk parashikohet në mënyrë të posaçme afat për të kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e mospranimit të padisë të vendosur nga gjykata e shkallës së parë, pra kemi një ometim. Në të tilla rrethana për të përcaktuar afatin kohor ligjor për kundërshtimin e vendimit të mospranimit të padisë si një ndër llojet e vendimit jopërfundimtar i referohemi Kodit të Procedurës Civile, për afatin që ai parashikon për kundërshtimin e vendimeve të tjera jopërfundimtare.

Sipas nenit 301 të K.Pr.Civile, afati për të kundërshtuar me ankim në Gjykatën e Apelit vendimin e pushimit të çështjes është afati i posaçëm 5 ditor.

Në të tilla rrethana Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vullneti i ligjvënësit ka qenë që, për të kundërshtuar me ankim vendimet jopërfundimtare të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, afati i ankimit të jetë i veçantë 5 ditor dhe afati i përgjithshëm i ankimit 15 ditor të jetë vetëm për vendimet përfundimtare sikurse e parashikon edhe neni 443/1 i K.Pr.Civile, ato të cilat çështjen e zgjidhin në themel dhe që palës e cila nuk është dakort me të, do ti duhet një kohë më e gjatë (e vlerësuar nga ligjvënësi 15 ditë) për tu njohur më këtë vendim përfundimtar dhe për të parashtruar në ankim shkaqet pse ajo nuk është dakort me të.

Ky konkluzion bazohet edhe në nenin 44 të ligjit 49/2012, i cili parashikon se: *“Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”*

Në vijim, në nenin 442/a i K.Pr.Civile përcaktohet se *“Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrajnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe*

veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.”

Sipas nenit 443 të K.Pr.Civile: “*Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.*

Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.

Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë është 30 ditë.

Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë.”

Në rastin konkret vendimi i kundërshtuar me ankim është një vendim jopërfundimtar i cili nuk e ka zgjidhur çështjen në themel. Pavarësisht faktit që gjykata e shkallës së parë i ka njohur të drejtën e ankimit palëve në këtë vendim brenda një afati kohor 15 ditor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, në këtë rast referuar analizës së sipërpërmendur, afati ligjor për të kundërshtuar këtë vendim jopërfundimtar nuk është 15 ditë, por është afat i veçantë 5 ditor.

Pala paditëse ka marrë dijeni në datën 08.10.2020 për vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ankimin e saj e ka depozituar në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë në datën 20.10.2020, pra jashtë afatit kohor ligjor 5 ditor.

Për sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit çmon se, duhet të vendosë mospranimin për shqyrtim të ankimit të paraqitur nga pala paditëse ndaj vendimit jopërfundimtar nr.____, datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor 5 ditor, të parashikuar nga neni 443 i K.Pr.Civile.

Vendimi i gjykatës: - Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.____, datë 14.09.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

8. Vendim nr.____, datë 16.04.2024, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

Paditës : S.K

Të paditur : Drejtorja e Hetimit Tatimor Shkodër
Drejtorja Rajonale Tatimore Shkodër

Objekti : - shfuqizimin e akt-konfiskimit me nr. serial _____, datë 07.10.2014, i cili mbështetet në akt-konstatimet nr.____ dhe nr. _____ datë 07.10.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

- Detyrimin e të paditurit të paguajë vlerën e mallit, i cili është konfiskuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, interesat bankare të vlerës deri në datën e marrjes nga Drejtoria e Tatimeve të kësaj vlere si dhe dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e kushteve të kontratës me blerësin.

Baza ligjore : Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar, për zbatimin e këtij ligji, Ligji nr.8438 dt.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligji nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, i ndryshuar

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Në bazë të kontrollit të ushtruar ndaj tatimpaguesit J.U me numër Nipti K____S, në mjetin “Kamion Scania AA____Y”, veprimtari ekonomike “transport mallrash” është mbajtur Akt konstatimi me numër serie _____ datë 07.10.2014 dhe në vijim ai me numër _____ datë 07.10.2014. Referuar përmbajtjes së këtyre Akt konstatimeve të mbajtur nga grupi i hetimit tatimor gjatë kontrollit, hetimit të ushtruar datë 07.10.2014, ndër të tjera rezultoi si vijon:

... u konstatua mallë pa faturë tatimore, ku u bë peshimi i mallit tek Dogana Shkodër, ku rezultoi pesha 10100 kg., lloji i mallit gështenja të paketuara në thasë.

Akt konstatimit ju bashkëngjiti fleta e peshores me nr.____ datë 07.10.2014.

Përsa i përket mallit të lartshënuar rezultoi i zotit S.K (paditësit) me mjet identifikimi, Kartë Identiteti H____O (fermer).

Në bazë të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u bë konfiskimi i mallit, duke u mbajtur edhe Procesverbali i konfiskimit me nr.serie_____, datë 07.10.2014, firnosur nga transportuesi J.U dhe si përfaqësuesi i mallit S.K. Gjithashtu, akt konstatimet janë firnosur, nënshkruar nga transportuesi J.U dhe si përfaqësuesi i mallit S.K.

Malli i konfiskuar është bërë hyrje në organin tatimor sipas Fletë-Hyrjes nr.____ datë 08.10.2014.

Në vijim, konform procedurave, mbi bazën e Urdhrit të brendshëm të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër nr.____ prot., datë 08.10.2014 dhe Procesverbalit të dorëzimit, mbajtur me datën 08.10.2014, malli në fjalë është dorëzuar në Drejtorinë Rajonale të Rezervave të Shtetit Pukë. Për mallin e dorëzuar është mbajtur dhe Fletë-Dalja Nr.____ datë 08.10.2014.

Vlerësimi i Gjykatës:

➤ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.____, datë 28.07.2015 ka vendosur:

- *Pranimin e padisë.*

- *Shfuqizimin e akt konfiskimit me nr. Serial _____ datë 07.10.2014, i cili mbështetet në akt konstatimet nr. _____ dhe _____, datë 07.10.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Tatimeve Shkodër.*

- *Detyrimin e të paditurit të paguajë vlerën e sasisë së mallit prej 10.100 kg gështenjë që i është konfiskuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin*

- *Shpenzimet gjyqësore (vlera e taksës së kërkesë padisë në masën 3000) lekë në*

ngarkim të anës së paditur.

- Mbi bazën e ankimit të palës së paditur çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj nr. ____, datë 31.01.2017 vendosi :
 - *Lënien në fuqi të vendimit nr. ____, datë 28.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;*
 - *Shpenzime gjyqësore nuk ka.*

- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. _____, datë 16.04.2024, ndër të tjera ka arsyetuar si vijon:

Kolegji vlerëson se, rekursat përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo dispozitë, para datës 05.05.2017 parashikonte se:

“Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur :

- a) ligji material nuk është respektuar është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë;*
- b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyimit;*
- c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit”.*

Referuar rrethanave të faktit të vërtetuara mbi bazën e provave përkatëse, të pranuar si të tilla nga dy gjykatat më të ulëta, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, Kolegji vlerëson, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit procedural e material. Kolegji vlerëson se nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes në përputhje me nenet 1(2), 17(2) të ligjit nr.49/2012 dhe nenit 14 të KPC. Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje të plotë të gjitha pretendimeve të ngritura në ankim nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, pretendime të bëra prezent dhe në rekursat objekt gjykimi. Gjykata Administrative e Apelit, në thelb ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë me të njëjtin arsyetim, ndërkohë që nga ana e ankuesve janë ngritur çështje të cilat nevojitej që t’u jepej përgjigje.

Pretendimet e ngritura në rekurs si nga pala e paditur dhe nga Avokatura e Shtetit janë të tilla, që për zgjidhjen e drejtë çështjes kërkohet një hetim më i plotë dhe lidhen me vlerësimin e provave gjë e cila nuk mund të kryhet nga Gjykata e Lartë, e cila është gjykatë ligji dhe pjesa e vlerësimit të provave del jashtë sferës së veprimit të Gjykatës së Lartë.

Kolegji konstaton, se Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se pala paditëse ka qenë fermer i regjistruar me numrin përkatës të fermerit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe për shitjen e prodhimeve të tij nuk mund të lëshojë faturë tatimore. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se ligji për procedurat tatimore kërkon që edhe fermeri të jetë i regjistruar.

Konkretisht neni 40, pika 4.1 (dh) e ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore” parashikon:
“Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: [...] dh) fermeri.

Po ashtu legjislacioni tatimor parashikon se malli nuk mund të lëvizë i pa shoqëruar me faturë. Mbi këto parashikime të ligjit si dhe provave të paraqitura nga palët ngrihen dhe çështjet në rekurs nga palët rekursuese, çështje të ngritura dhe në ankimet e paraqitura përpara Gjykatës Administrative të Apelit, që kjo e fundit nuk u ka dhënë përgjigje.

Kolegji vëren se legjislacioni tatimor vërtet parashikon, se në rastet e furnizimeve të mallrave nga fermerët, personi i tatueshëm i cili blen mallin lëshon një faturë për fermerin me specififikimet përkatëse, por kjo nuk mund të merret apriori, pasi nevojitet të sqarohet mënyra e realizimit të këtij procesi, pasi legjislacioni tatimor sikundër sqaruar më lart, parashikon si detyrim për regjistrimin e fermerit në organet tatimore si dhe ndalimin e lëvizjes së mallit pa faturë. Transporti është një proces që zgjat nga vendi i ngarkimit (nisjes) së mallit deri në arritjen në destinacion tek blerësi. Në rastin konkret, pra për furnizimin që kryhet nga fermeri, apo blerjes së mallit nga një individ (fermer) i paregjistruar nevojitet që gjykatat të bëjnë një hetim më të zgjeruar dhe të plotë, me qëllim përcaktimin e saktë të momentit që do të konsiderohet si dorëzim i mallit nga fermeri dhe po ashtu momentin kur blerësi duhet të lëshojë faturën për fermerin (shitësin/furnizuesin). Ky hetim duhet të kryhet mbi pretendimet e palëve dhe provave në mbështetje të tyre të lidhura me parashikimet ligjore/nënligjore që rregullojnë rastin konkret.

Gjithashtu Kolegji vëren, se nga ana e gjykatave më të ulëta nuk është sqaruar dhe përcaktuar në mënyrë të saktë vlera e detyrimit që i është ngarkuar palës së paditur, sa do të ishte kjo vlerë dhe mbi ç'referencë (mënyrë) do të përlllogaritet kjo vlerë.

Kolegji vlerëson si të gabuar konkludimin e dy gjykatave, se mos shënimi i orës në aktet e konstatimit të palës së paditur i bën aktet të pavlefshme. Mungesa e evidentimit të orës së ushtrimit të kontrollit nuk është element mungesa e të cilit passjell pavlefshmërinë e aktit. Ushtrimi i kontroleve nga organet tatimore me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit tatimor nga ana e subjekteve, konstatimi i paligjshmërisë dhe marrja e masave përkatëse siç parashikon ligji nuk është i kufizuar dhe as mund të kufizohet në kohë.

Për sa më sipër, për shkak të këtyre shkeljeve të rënda procedurale që lidhen me një hetim dhe arsyetim jo të plotë të gjithë kërkimeve dhe prapësimeve të palëve dhe që kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet e çështja të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Vendimi i Gjykatës:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. _____, datë 16.04.2024, ka vendosur :

- *Prishjen e vendimit nr. _____, datë 31.01.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.*

9. Vendim nr. _____, datë 07.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës : A. L.L.E

Të paditur : Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti: Shfuqizimi i aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____, datë 28.09.2015, i lënë në fuqi me vendimin nr.____ prot., datë 17.12.2015, të Komisionit të Apelit Tatimor

Shuma e detyrimit tatimor : _____ lekë

Baza ligjore: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 119 pika 1 gërma (a), “mosdeklarimi i punonjësve”, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar, Ligji nr.9136 dt.11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.26 datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin “A.LL.E”, sh.p.k me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.----, datë 28.09.2015, nr.----, datë 09.10.2015, dënim për dy punonjës të padeklaruar në vlerën totale prej _____ lekë, bazuar në nenin 119.1.a të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga grupi i kontrollit tatimor referuar konstatimit të bërë dhe pasqyruar të dhënat mbi gjendjen e faktit në Akt konstatimin e sipërpërmendur është mbajtur dhe Procesverbali i gjobës me numër serie _____ datë 08.09.2015 sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjoba në vlerën totale _____ lekë për “punonjës të padeklaruar” para organit tatimor, bazuar në nenin 119.1.a të Ligjit nr.9920, datë19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Dy punonjësit e gjendur në punë ditën e konstatimit, subjekti i ka deklaruar si të punësuar para organit tatimor **në datën 08.09.2015, me datë fillimi pune 09.09.2015**, pra në ditën e konstatimit të bërë (*është paraqitur para gjykatës me vlerën e provës Deklarata “E-Sig 027 – Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishitazi si dhe e të larguarve nga puna Nr.178 datë 08.09.2015”, deklarim i vetë subjektit, e cila pasqyron këtë fakt*).

Në lidhje me sa pretendonte subjekti paditës, se dy punonjësit ishin në testim paraprak, ligjvënësi me akte nënligjore ka përcaktuar shprehimisht procedurën që duhet të ndiqet nga tatimpaguesi dhe në rastet e testimi profesional. Subjekti nuk përjashtohet nga detyrimi ligjor për deklarimin e kësaj kategorie punonjësish me formularin “E-SIG – Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishitazi si dhe e të larguarve nga puna” dhe llogaritjen e atij lloj kontributi për këtë kategori punonjësish sipas specifikimeve në V.K.M-në nr.77 datë 28.01.2015, i ndryshuar.

Vlerësimi i Gjykatës:

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____, datë 26.12.2017, nëpërmjet të cilit vendosi:
 - *Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e në prova.*
- Mbi bazën e ankimimit të palës paditëse çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj ndryshon vendimin nr.____, datë 26.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për arsyet e mëposhtme:

Me njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore datë 28.09.2015 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër është njoftuar pala paditëse për detyrimin tatimor gjobë në shumën _____ lekë.

Gjykata Administrative e Apelit evidenton faktin, se ky njoftim vlerësim tatimor është nxjerrë duke u bazuar në nenin 119 të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i cili është ndryshuar me ligjin nr.99/2015 datë 23.09.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Konkretisht me ligjin nr.99/2015 datë 23.09.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" është bërë ky ndryshim :

Neni 14, Neni 119 ndryshohet si më poshtë :

Neni 119 "Mosdeklarimi i punonjësve"

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton, se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përvec detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shendetësore të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë prej 500 000 (peseqind mijë) lekësh

2. Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve pas aplikimit të dënimit administrativ si në pikën 1 të këtij neni konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131 të këtij ligji duke bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin.

Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton, se tatimpaguesi, i cili nuk ka deklaruar në organin tatimor cdo të punësuar rishtazi të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës dënohet me gjobë prej 500 000 (peseqind mijë) lekësh.

Kjo dispozitë është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.33 datë 08.06.2016.

Lidhur me fuqin detyruese të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese në çështjen objekt gjykimi, Gjykata Administrative e Apelit çmon t'i referohet Ligjit Nr.8577 datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Referuar nenit 76, pika 6 të këtij ligji, vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm :

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë

c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

Në çështjen konkrete, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se vendimi nr.33 datë 08.06.2016 i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese në çështjen objekt gjykimi, përse kohë padia është paraqitur në datë 14.01.2016, pra para hyrjes në fuqi të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese dhe ka vijuar të jetë në gjykim në çastin që vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi.

Duke qene se me Vendimin nr.33 datë 08.06.2016 Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar nenin 119 të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.99/2015 datë 23.09.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i cili është dhe baza ligjore e nxjerrjes së aktit administrativ objekt gjykimi atëherë konsiderohet, se gjoba e vendosur ndaj palës paditëse nuk është proporcionale dhe e arsyeshme për të rivendosur balancën e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit për një ekonomi të formalizuar dhe kërkesave të mbrojtjes së lirisë së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës së tatimpaguesve.

Për rrjedhojë njoftim vlerësimi tatimor nr.____ prot., datë 09.10.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër është nxjerrë në kundërshtim me arsyetimin e Vendimit nr.33 datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese dhe Ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",

i ndryshuar dhe si i tillë ai duhet shfuqizuar.

Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se, meqënëse mosmarrëveshja administrative objekt gjykimi ka të bëjë me kundërshtimin e dënimit për kryerjen e një kundërvajtje administrative, e cila është më e vogël se dyzetfishi i pages minimale në shkallë vendi, ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim, kjo bazuar në gjermën (a) të nenit 56 të ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Vendimi i gjykatës :

➤ Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.____, datë 07.11.2024 vendosi :

- *Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 26.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- *Pranimin e padisë...*

10. Vendim Nr.-----, datë 06.12.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: L.K (Person Fizik);

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhë.
Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Ministrisë së Financave

Pjesëmarrëse: Avokatura e Shtetit.

Objekti:

- Shfuqizimi i aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr. ____ prot, datë 26.09.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë

- Shfuqizimin e aktit administrativ, vendim nr.-----, datë 19.12.2016, i Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza ligjore: Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë (DRT Lezhë) në datën 20.08.2016, ka ushtruar kontroll pranë subjektit L. K, i cili ushtron aktivitetin bar-restorant-hotel me emrin tregtar "H.P". Inspektorët kanë mbajtur aktet e konstatimit me nr.-- dhe nr.--, datë 20.08.2016, ku është konstatuar se punonjësi A.P, i datëlindjes 10.04.1994, ishte i padeklaruar si punonjës në organin tatimor.

DRT Lezhë, bazuar në aktin e konstatimit nr. _____, datë 20.08.2016, me akt vlerësimi të dates 15.09.2016, ka dënuar me gjobë në shumën ___ lekë palën paditëse, bazuar në pikën 1 të nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar.

Në vijim, DRT Lezhë ka nxjerrë njoftimin e vlerësimit nr. ____ prot, datë 26.09.2016, për detyrimin tatimor të gjobës prej --- lekë ndaj subjektit L.K, bazuar në aktin e konstatimit nr. _____, datë 20.08.2016.

Pala paditëse L.K ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj njoftimit të vlerësimit për detyrimet tatimore në Drejtorinë e Apelimit Tatimor (DAT), e cila, pasi ka shqyrtuar ankimin me vendimin nr. ____ prot., datë 19.12.2016, ka vendosur: "Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi, Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr.--- prot., datë 26.09.2016, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën ____ lekë dhe hedhjen poshtë të ankimit..."

Në këto rrethana, pala paditëse L.K, duke thirrur në gjykim si palë të paditur DRT Lezhë dhe DAT, i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke kërkuar pranimin e saj.

Vlerësimi i Gjykatës

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.-----, datë 09.10.2017, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesëpadisë". Në këtë vendim, Gjykata arsyeton si vijon:

Provohet se ndaj subjektit tatimpagues është ushtruar kontroll nga administrata tatimore i tipit verifikim në vend, i pajisur me urdhër pune nr. ____, datë 19.08.2016, në vendndodhjen e vetë subjektit, ku është mbajtur dhe akti i konstatimit me nr. serial ----, datë 20.08.2016, në të cilin është bërë përshkrimi i gjendjes së faktit ku thuhet: "Në punë u gjet ndër të tjerë... dhe A.P, i cili nuk kishte kartë identiteti me vete, por u identifikua me datëlindje 10.04.1994". Akti në fund është firmosur nga vetë L.K.

Më datë 15.09.2016, nga zyra e vlerësimit tatimor është mbajtur procesverbali i vlerësimit (brenda afatit ligjor që parashikon neni 96 i ligjit nr. 9920/2008), ku nga verifikimi i deklaratave të vetë subjektit, sipas E-sig 027, rezulton se: A.P, i datëlindjes 10.04.1994, ishte i padeklaruar në organin tatimor.

Referuar nenit 68 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Vlerësimi tatimor":

I. Vlerësimi tatimor

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore;
5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:

- a) informacionin që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
- b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji;
- c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

7. Kur një vlerësim bëhet në përputhje me shkronjat "b" ose "c" të pikës 5 të këtij neni, barra e provës që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.

Detyrimet e vlerësuara prej ___ lekë janë hedhur në sistemin informatik tatimor dhe janë pasqyruar në njoftimin e vlerësimit nr.---- prot, datë 26.09.2016, objekt gjykimi, duke njoftuar subjektin, në përputhje me procedurat ligjore...

- Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se ankimi i paraqitur nga paditësi L.K përmban shkaqe që e bëjnë të cënueshëm vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe për rrjedhojë ai duhet pranuar, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe shfuqizuar aktet administrative. Sa i përket të drejtave të ankimit/rekursit, në bazë të nenit 56, shkronjat 'a' dhe 'b' të ligjit nr. 49/2012, për shkak të vlerës se detyrimit (gjobës), me më pak se dyzetfishin e pagës minimale, ndaj këtij vendimi nuk mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në lidhje me inspektorët të cilët kanë kryer kontrollin pranë subjektit tatimpagues, Gjykata eidenton si vijon:

- Njëri prej tyre është inspektor i parë në periudhë prove në sektorin e verifikimit në terren në Drejtorinë e Kontrollit në DRT Lezhë;
- Ndërsa tjetri nuk është inspektor dhe nuk ka status nëpunësi civil, por është Llogaritar/Arkëtar në sektorin e funksioneve mbështetëse në DRT Lezhë.

Këto momente nxjerrin në pah handikapi në raport me vetë cilësitë e personave që kanë ushtruar kontrollin tatimor pranë palës paditëse për llogari të palës së paditur. Ky moment cënon drejtpërdrejtë vetë procedurën konkrete në të cilën është konfiguruar ky kontroll tatimor/inspektim në vend dhe pasuar me dënim administrativ përkundrejt palës paditëse.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Ndryshimin e vendimit nr. _____, datë 09.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- *Pranimin e padisë.*
- *Shfuqizimin si të paligjshëm të njoftimit të vlerësimit për detyrimet tatimore nr. ___ prot, datë 26.09.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.*
- *Shfuqizimin si të paligjshëm të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. _____ Prot, datë 19.12.2016.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.*
- *Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.*

11. Vendim nr. _____, datë 23.10.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria "V.A" sh.a

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti: - Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. _____ prot, datë 14.04.2014 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nxjerrë në ngarkim të shoqërisë "S" sh.p.k, e përthithur në datën 03.06.2024 nga shoqëria "A" shpk

- Shfuqizimi i vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor me nr. _____, prot, datë 16.04.2018.
- Detyrimi i palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të kthejë shumën e detyrimit tatimor dhe interesat e sistemit, të paguara nga pala paditëse, sipas Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. _____ prot., datë 14.04.2014.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza ligjore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet akt-vlerësimit të datës 26.03.2014 lidhur me sistemimin e situatës së tatim fitimit për periudhën 2010 deri me 2012 të shoqërisë së përthithur "S" shpk ka llogaritur një detyrim në total për t'u paguar në vlerën _____ lekë. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. _____, datë 14.04.2014, i ka komunikuar tatimpaguesit "S" shpk detyrimet tatimore.

Kundër aktit të mësipërm, shoqëria "A" shpk ka paraqitur ankimin administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor në datë 17.01.2018. Kjo e fundit me shkresën nr. _____ prot., datë 16.03.2018 i ka kërkuar DRT Tiranë plotësimin e dokumentacionit me dërgimin e datës së dërgimit në shërbimin postar të njoftim vlerësimit dhe datën e marrjes dijeni nga tatimpaguesi. Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin nr. _____, datë 16.04.2018 ka vendosur: Refuzimin e ankimit pasi nuk është respektuar afati ligjor i përcaktuar në nenin 106 të Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Shoqëria "A" shpk në cilësinë e palës paditës, duke mos qenë dakord me këtë vendim, i është drejtuar me padi në datë 14.05.2008 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes ka vendosur:

1. *Mospranimin e padisë...*

Vendimi i sipërcituar është ankimuar nga ana e pala paditëses në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e ka lënë në fuqi Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke arsyetuar si vijon:

Shoqëria “A” ka pasur të drejtë të ankimojë Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. _____ prot, datë 14.04.2014, përderisa ky akt përcaktonte detyrime tatimore në ngarkim të një subjekti që kjo shoqëri e ka përthithur me marrëveshje ligjore. Për shkak të kësaj marrëveshje përthithje, detyrimet e caktuara për subjektin “S” i kalonin shoqërisë “A” shpk. Pala paditëse ka marrë dijani për këtë akt në datë 19.12.2017. Por duke qënë se akti ka dalë më datë 14.04.2014 dhe vlerësohet se i është njoftuar subjektit në datë 21.04.2014 ndaj këtij akti nuk mund të bëhet ankim administrativ pa u rivendosur në afat. Pala paditëse duhet të paraqiste kërkesën për rivendosje në afat së bashku me ankimin administrativ, brenda 15 ditëve duke filluar nga data 19.12.2017. Në fakt shoqëria “A” shpk ka paraqitur ankim administrativ në datë 17.01.2018, pra jashtë afatit 15 ditor për paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat dhe bashkë me të dhe ankimin e saj.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se pala paditëse si në gjykimin në shkallë të parë ashtu edhe në ankim nuk ka paraqitur asnjë provë që të justifikojë objektivisht pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankimit të tij ndaj aktit objekt gjykimi. Bashkimi i shoqërive ndërmjet procedurës së përthithjes, nuk ligjëron mosushtrimin e mjeteve efektive ligjore për të realizuar të drejta të mbrojtura nga ligji. Shoqëria paditëse në kohën që ka ndërmarrë veprime ligjore për t’u bashkuar me shoqërinë “S” shpk që ishte ngarkuar më parë me detyrime tatimore të pakundërshtuara në rrugë ligjore, duhet të tregonte vigjilencën e duhur dhe në drejtim të ushtrimit të mjeteve ligjore efektive kundër mbartjes së detyrimeve tatimore të papaguara nga shoqëria “S” shpk.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. _____, datë 23.10.2024, vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

12. Vendim nr._____, datë 28.10.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria “A Construction” sh.a

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë
Komisioni për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave

Objekti: - Shfuqizimin e pjesshëm të Njoftim Vlerësimit Tatimor nr. _____, datë 13.11.2014, të lëshuar nga Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë;
- Shfuqizimin e pjesshëm të Vendimit të Drejtorisë së Apelimit nr. _____ prot., datë 31.03.2014;
- Regullimin e pasojave duke regulluar situatën financiare të paditësit pas shfuqizimit.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria “A Construction” sh.a, është degë e përfaqësimit të shoqërisë së huaj me veprimtari sipërmarrje, supervizion, financim të të gjitha llojeve të ndërtimeve publike, e regjistruar rregullisht pranë QKB-së.

Inspektorët e palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, kanë ushtruar kontroll me objekt konrolli tatim fitimin viti 2012 (janar-dhjetor) dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën nga kontrolli i fundit deri në prill 2014.

Nga kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve, inspektorët kanë konstatuar një diferencë me vlerë _____ lekë midis të ardhurave sipas bilancit me të ardhurat sipas situatës financiare. Kjo diferencë ka rezultuar nga rivlerësimi i të ardhurave njoftuar sipas Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore nr. _____ prot., dt. 28.04.2014. Mbi këtë bazë pala e paditur ka llogaritur tatim fitimin dhe të pazbritshme në shumën _____ lekë. Meqënëse subjekti tatimpagues është me humbje, pala e paditur ka vendosur që palës paditëse duhet t'i ulet humbja në shumën _____ lekë.

Nga kontrolli i shpenzimeve të vitit 2012, pala e paditur ka konstatuar se shoqëria ka përfshirë në shpenzimet e zbritshme, blerjet për konsumin e kafes dhe ujit në shumën _____ lekë, duke i vlerësuar se këto shpenzime janë të karakterit personal dhe të pazbritshme. Nga kontrolli ka rezultuar se shoqëria ka përfshirë në shpenzime të zbritshme, shpenzimet e bëra për efekt të faturës të bërë nga shoqëria “G” në vlerën _____ lekë, e cila përmban përshkrimin e punimeve për rikonstruksionin e zyrave, zyra të cilat janë marrë me qira nga një person i pa regjistruar në organet tatimore, shpenzime të cilat Drejtoria Tatimore Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, i ka vlerësuar si të pazbritshme dhe ka ulur humbjen për vlerën _____ lekë. Në shpenzimet e vitit 2012 shoqëria ka përfshirë në shpenzimet e zbritshme, shpenzimet e personelit të jashtëm në shumën _____ lekë, të cilat kanë të bëjnë me blerjen e shërbimeve për kontrollin e punimeve në ndërtimin e rrugës nga persona jorezidentë në Shqipëri, nga individë të ndryshëm nga Greqia. Pala e paditur ka vlerësuar se këto shpenzime nuk mund të konsiderohen të zbritshme dhe ka ulur humbjen. Nga kontrolli ka rezultuar se shoqëria ka vendosur në shpenzime ato të bëra për marrjen me qira të makinerive të rënda me vlerën _____ lekë, të marra nga një shtetas resident në Greqi, faturë e cila rezulton në gjuhën greke.

Drejtorja Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka vlerësuar se shoqëria ka një diferencë prej _____ lekë ndërmjet bilancit dhe situatës financiare, të cilat janë të pavërtetuara me dokumentacion dhe ka ulur humbjen në shumën _____ lekë dhe ka dënuar palën paditëse me gjobë në masën 25% të tatim fitimit në shumën _____ lekë.

Me Njoftim Vlerësimin Tatimor nr.____, datë 12.11.2014 Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbështetur në të dhënat e Raport Kontrollit, ka nxjerrë detyrimet tatimore të shoqërisë në shumën _____ lekë, tatim fitim për vitin 2012 dhe gjobën me shumën _____ lekë detyrim për tatimin në burim të vitit 2012 shumën _____ lekë dhe gjobën në shumën _____ lekë dhe ulje humbje për vitin 2012 në shumën _____ lekë.

Shoqëria ka ndjekur procedurat ankimore në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë. Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtoria e Apelimit Tatimor me Vendim nr.____, dt. 31.03.2015 ka vendosur ndryshimin e aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi Tatimor, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si vijon:

Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor, nxjerrë nga DRT Tatimpaguesve të Mëdhenj për detyrimet:

- *Tatim në burim 2012 detyrimi _____ lekë: gjobë _____ lekë*
- *Ulje humbje 2012 _____ lekë.*
- *Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj për detyrimet:*

- *Tatimi në burim 2012 detyrimi _____ lekë: gjobë _____ lekë.*
- *Ulje humbje 2012 detyrimi _____ lekë.*

Pala paditëse duke mos qenë dakord me këto akte, në datë 30.04.2015 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. _____, datë 11.07.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar si të bazuar në ligj përfundimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë, duke konfirmuar qëndrimin e saj se vlerësimi i të ardhurave është i lidhur ngushtë me vlerësimin e kryer nëpërmjet Raport Kontrollit nr. _____ prot., dt. 28.04.2014.

Të gjitha ankimet, të parashtruara në formë pretendimesh nga ana e palës paditëse, gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, u është dhënë përgjigje shteruese nga ana e kësaj gjykate, përmes një analize të hollësishme ligjore në koneksitet me faktet dhe provat që i janë nënshtruar debatit gjyqësor, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 42 të Kushtetutës, parim i konkretizuar gjithashtu në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. _____, datë 28.10.2024, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të Vendimit nr. _____, datë 11.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.